



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



**KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG**

Si e sheh Kina Ballkanin Perëndimor, Kosovën dhe Dialogun e Normalizimit?



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



Si e shoh Kina Ballkanin Perëndimor, Kosovën dhe Dialogun e Normalizimit?

Published by:

© Kosovar Centre for Security Studies (KCSS)

Autorë:

Ramadan Ilazi, Delmin Saljunovic dhe Matt Delvoe

Recenzente:

Jeta Loshaj, Hulumtuese, QKSS

Vendi dhe data:

Prishtinë, 7 korrik 2025

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Konrad-Adenauer-Stiftung. Ky botim shërben vetëm për qëllime informative. Ai nuk mund të përdoret nga partitë politike ose nga aktivistët apo mbështetësit zgjedhorë për qëllime të reklamës zgjedhore.



DIZAJNI:

Brand Vision Shpk

Kontakti: +383 45 559 923

Email: brandvision.rks@gmail.com

© Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë ato të autorit. Të drejtat e pronësisë intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 08/L-205 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Të drejtat e botimit janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe Fondacioni Konrad Adenauer (Konrad-Adenauer-Stiftung – KAS). Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem arkivimi apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mënyre – elektronike, mekanike apo tjetër – pa lejen paraprake të botuesve.

Përmbajtja

Rreth autorëve	4
Lista e akronimeve	5
1. Hyrje	6
2. Një përpyetje për të kuptuar qasjen e politikës së jashtme të Kinës	8
3. Ballkani Perëndimor si rast për interpretimin e politikës së jashtme kineze	12
4. Analiza e diskursit të politikës së jashtme kineze ndaj Kosovës	15
4.1 Gjetjet kryesore.....	16
5. Analiza e qëndrimit të politikës së jashtme të Pekinit ndaj Ballkanit Perëndimor	19
5.1 Ballkani Perëndimor në diskursin e politikës së jashtme të Kinës.....	19
5.2 Kosova në diskursin e politikës së jashtme të Kinës.....	23
5.3 Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi në diskursin e politikës së jashtme të Kinës.....	26
6. Konkluzion	28
Referencat	29


Rreth autorëve

Dr Ramadan Ilazi



Aktualisht shërben si Udhëheqës i Hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Titullin PhD në Politikë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare e ka marrë nga Dublin City University, Irlandë, ndërsa master në Studime të Konfliktit dhe Paqes nga Universiteti St. Andrews, Skoci, si bursist i Chevening. Dani është Bashkëpunëtor për Hulumtime për Programin e Evropës Juglindore të Fondacionit Helenik për Politikë Evropiane dhe të Jashtme (ELIAMEP) si dhe ka mbajtur pozitën si zëvendës ministër i Integritimit Evropian në Qeverinë e Kosovës nga viti 2015 deri në vitin 2016. Libri i tij më i fundit është “Bashkimi Evropian dhe Shtetndërtimi i Përditshëm: Rasti i Kosovës” (Routledge, 2022).

Delmin Saljunovic



Është student i vitit të fundit në Rochester Institute of Technology në Kosovë, duke ndjekur një program të dyfishtë në Studime të Konfliktit dhe Paqes dhe Ekonomi. Është vlerësuar në Listën e Dekanit për pesë semestra rresht. Aktualisht, është praktikant në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë. Më parë ka punuar me Qendrën për Dialog Humanitar, Qendrën për Paqe dhe Konflikt Fred C. Cuny dhe Stacion – Qendrën për Art Bashkëkohor. Përmes këtyre roleve, ai ka fituar përvojë praktike në hulumtime, analiza të politikave dhe çështje të sigurisë rajonale. Veprimtaria e tij akademike është e fokusuar në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërtimin e paqes në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor, me theks të veçantë në dinamikën e sigurisë dhe çështjet ndërkombëtare të Kosovës.

Matt Delvoye



Është i diplomuar në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universitë libre de Bruxelles dhe Universiteti i Liège-it. Më parë ka kryer praktikë në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), ku ka asistuar në hulumtimet për diskursin e politikës së jashtme të Kinës në Ballkanin Perëndimor, me fokus të veçantë në analizën e diskursit dhe narrativat strategjike. Interesat e tij akademike përfshijnë politikën e jashtme të BE-së, gjeopolitikën në rajonet pas konfliktit, si dhe rolin e narrativave në marrëdhëniet ndërkombëtare. Matt ka hulumtuar edhe përgjigjet evropiane ndaj Iniciativës “Një Brez, një Rrugë” të Kinës, si dhe evolucionin e politikës për mbrojtjen të Danimarkës.

Lista e akronimeve

AIIB	Banka Aziatike për Investime në Infrastrukturë
BRI	Iniciativa Një Brez, një Rrugë
PKK	Partia Komuniste Kineze
CGTN	Rrjeti Global Televiziv i Kinës
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit - Kosovë
GjND	Gjykata Ndërkombëtar e Drejtësisë
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme (e Republikës Popullore të Kinës)
UÇP	Ushtria Çlirimtare Popullore
RPK	Republika Popullore e Kinës
ReK	Republika e Kinës (Tajvani)
SCO	Organizata e Bashkëpunimit të Shangait
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNGA	Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
KS i OKB-së	Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
SHBA	Shtetet e Bashkuara
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

1. Hyrje

Angazhimi i Kinës në Ballkanin Perëndimor merr formë përmes një miksi të qasjeve ideologjike dhe pragmatike. Teksa rajoni i Ballkanit Perëndimor nuk është çështje qendrore në politikën e jashtme të Pekinit, ai ofron një hapësirë kritike gjeopolitike dhe për zhvillim të diskursit përmes të cilit Kina e sfidon Perëndimin dhe teston elemente të strategjisë së vet më të gjerë për marrëdhëniet ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, aspirata e Kinës është të jetë rivale e Perëndimit në Ballkan, kryesisht përmes konkurrencës ekonomike, duke e parë si mundësi predikimi për vlerat e veta politike për rendin ndërkombëtar (ose botëkuptimin e vet) si model i cili, sipas kinezëve, është më i mirë se modeli i integritit rajonal dhe evropian i ndjekur bashkërisht nga Ballkani Perëndimor me Perëndimin. Në këtë kontekst, Kosova shquhet si rast i rëndësishëm. Për Kinën, Kosova nuk është thjesht shtet i kontestuar nga Serbia, por mjet përmes të cilit Kina artikulon kundërshtimet e veta ndaj Perëndimit dhe demokracisë liberale, ndërkohë që konsolidon aleancën e vet me Serbinë. Ky punim argumenton se qëndrimi i Kinës ndaj Kosovës nuk udhëhiqet nga parime ligjore, por nga dobia politike. Kosova trajtohet si “projekt perëndimor” që duhet delegitimuar dhe jo si kontest që duhet zgjidhur.

Ky punim është i organizuar në pesë seksione. Punimi fillon me seksionet një dhe dy, ku pasqyrohet diskutimi konceptual i politikës së jashtme kineze, duke synuar që të hidhen themelet për t’i kuptuar parimet bazë që udhëheqin filozofinë e politikës së jashtme kineze. Seksioni i tretë diskuton praninë e Kinës në Ballkanin Perëndimor dhe qasjen e varësisë nga e shkuara, e cila zbatohet nga politika e jashtme kineze. Seksioni i katërt paraqet analizën e diskursit të politikës së jashtme kineze, në mënyrë që të ekzaminohet gjuha specifike e përdorur nga Kina kur diskutohet për Kosovën, Serbinë dhe procesin e normalizimit, bazuar në një analizë të 82 teksteve me më

shumë se 30,000 fjalë, ku përfshihen deklarata zyrtare, fjalime dhe intervista nga zyrtarë, kryesisht nga viti 2008 deri në vitin 2024. Seksioni i pestë aplikon një këndvështrim më kritik ndaj qëndrimeve, duke e plasuar qasjen e Kinës brenda interesave të veta më të gjera në Ballkanin Perëndimor. Ky punim gjurmon pozicionimin e Kinës ndaj Kosovës, një temë e cila deri më sot ka qenë kryesisht e paeksploruar në Kosovë, duke u mbështetur në deklaratat zyrtare kineze, fjalimet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, njoftimet e MPJ-së dhe vizitat diplomatike. Në esencë, punimi identifikon edhe një model konsistent të distancës retorike të shoqëruar me përafrim me Serbinë.

Gjetjet kryesore të punimit janë të trefishta. Pikë së pari, diskursi i Kinës për Kosovën bazohet në një kornizë legaliteti në dukje, veçse retorike dhe oportuniste në praktikë. Gjithsesi, përkundër fasadës së legalitetit, Kina gjithmonë e ka injoruar opinionin e vitit 2010 të GjND-së për pavarësinë e Kosovës. Së dyti, politika e jashtme e Kinës ndaj Ballkanit Perëndimor nuk është neutrale, por është qartazi e përafruar me Serbinë, si në retorikë ashtu edhe në teknikalitete, dhe kjo e bën Serbinë një platformë kyçe për ndikimin kinez në rajonin tonë, siç është treguar edhe nga studime të tjera.¹ Së treti, edhe pse e mbështet në parim dialogun e normalizimit të udhëhequr nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Kina e minon procesin duke refuzuar t’i mbështesë objektivat e tij, duke u distancuar nga nocioni i “normalizimit”, si dhe duke promovuar

1 Shih për shembull: Ana Krstinovska, Bledar Feta, Aleksandra Stankovic, Senada Selo Sabic, Aleksandra Davitkovska-Spasovska dhe Momcilo Radulovi. (2023). “Ndikimi i Kinës në procesin e anëtarësimit në BE të Ballkanit Perëndimor: sinerji dhe pengesa”; Stefan Vladisavljev (2021). ‘Rruga Digjitale e Mëndafshit’ nga Kina futet në Ballkanin Perëndimor. Pragë, Republika Çeke, Asociacioni për Punë të Jashtme (AMO); Teuta Avdimetaj dhe Ramadan Ilazi. (2021). “Përtej konsideratave ekonomike: kufij të rinj të ndikimit kinez në Ballkanin Perëndimor”, Sbukner

një status quo që favorizon dykuptimësinë përpara zgjidhjes. Për Kinën, Kosova nuk është çështje që duhet zgjidhur, por projekt liberal-demokratik perëndimor që duhet të dështojë. Me fjalë të tjera, qëndrimi i Kinës ndaj Kosovës

ka mbetur kryesisht i njëjtë prej vitit 1998, duke e parë “zgjidhjen” e Kosovës në një mënyrë që i përshtatet më së miri interesave të Serbisë, çka bëhet kryesisht për shkak të Tajvanit, siç mëton të tregojë ky punim.

2. Një përpjekje për të kuptuar qasjen e politikës së jashtme të Kinës

Partia Komuniste Kineze (PKK) është arkitektja dhe zbatuesja e vetme e politikës së jashtme dhe marrëdhënieve të jashtme të Kinës, duke sajuar një përzjerje të vizionit të vet revolucionar për vendin me një farë pragmatizmi ndaj zhvillimeve globale. Në këtë kuptim, politika e jashtme kineze është njëkohësisht e ngurtë nga pikëpamja ideologjike dhe elastike nga pikëpamja taktike. Ky seksion ekzaminon strukturat, ideologjitë udhëheqëse dhe instrumentet operacionale të politikës së jashtme kineze, me fokus të posaçëm në periudhën nën Xi Jinping dhe me kontributet konceptuale të Marc Lanteigne dhe Thomas W. Robinson.

Nga studiuesit, trashëgimia e **“shekullit të poshtërimit”** dhe ndërgjegjësimi i thellë për sovranitetin shtetëror, mosndërhyrjen dhe integritetin territorial, konsiderohen si faktorët madhorë që formësojnë marrëdhëniet ndërkombëtare të Pekinit. “Shekulli i Poshtërimit” i referohet pak a shumë periudhës mes viteve 1839 dhe 1949, gjatë së cilës Kina pësoi një sërë disfatash ushtarake, humbesh territoriale dhe ndërhyrjesh të huaja. Kjo periudhë filloi me Luftën e Parë të Opiumit (1839–1842), e cila çoi në Traktatin e Nankinit dhe humbjen e Hong Kongut, dhe u pasua nga konflikte të mëvonshme, duke përfshirë Luftën e Dytë të Opiumit, Luftën Sino-Japoneze (1894–1895) dhe pushtimin e huaj të pjesëve të Kinës. Fundi i saj erdhi me themelimin e Republikës Popullore të Kinës në vitin 1949. Narrativa e poshtërimit kombëtar është kthyer në komponent qendror të identitetit kombëtar kinez. Partia Komuniste Kineze e përdor shpesh këtë parim për të legjitimuar sundimin dhe qëllimet e veta të

politikës së jashtme.² Një tjetër faktor madhor, në mos qendror, që i jep formë politikës së jashtme kineze, veçanërisht në lidhje me Kosovën, është themelimi i Republikës së Kinës në Tajvan (ReK).

Sipas Thomas W. Robinson, sjellja e jashtme e Kinës është e rrënjësuar në konceptimin realist të marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe po e kombinon gjithnjë e më shumë këtë realizëm me ushtrimin e autoritetit në rrafshin ndërkombëtar si mënyrë për ta rifituar pozitën e vet qendrore në rendin global.³ Kina ndjek një qasje sovraniste ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare. Marc Lanteigne elaboron më tej se themelet e politikës së jashtme kineze kanë ndryshuar ndjeshëm nën drejtimin e Xi Jinping, veçanërisht pas vitit 2013. Udhëheqja e Xi sinjalizoi largimin nga maksima e kujdesshme e Deng Xiaoping-ut taoguang yanghui (fshihe fuqinë, prit kohën e duhur), duke e zëvendësuar me një qëndrim shumë më proaktiv.⁴ Siç thotë Lanteigne, politika e jashtme e Kinës sot është një përzjerje e realizmit mbrojtës dhe ushtrimit të fuqisë ekonomike, duke synuar krijimin e një mjedisi të jashtëm të favorshëm për **ripërtëritjen kombëtare**. Ky ndryshim pasqyron bindjen e Kinës se ekuilibri global i fuqisë është në ndryshim dhe se dominimi i Perëndimit pas Luftës së Ftohtë është duke u kontestuar. Andaj, Pekini

2 Alison A. Kaufman. 10 mars, 2011. Dëshmi në dëgjuesën e Komisionit për Shqyrtim Ekonomik dhe të Sigurisë SHBA-Kinë për “Narrativat e Kinës në lidhje me politikën për siguri kombëtare”. <https://www.uscc.gov/sites/default/files/3.10.11Kaufman.pdf>

3 Robinson, Thomas W., dhe David Shambaugh, eds. Politika e jashtme kineze: teoria dhe praktika. Oxford: Clarendon Press, 1996.

4 Lanteigne, Marc. Politika e jashtme kineze: hyrje: botimi i katërt. Londër: Routledge, 2019.

mëton t'u japë formë normave, institucioneve dhe infrastrukturës ekonomike të çështjeve ndërkombëtare në përputhje me vizionin e vet për botën, në vend që thjesht t'u përshtatet atyre.

Politika e jashtme kineze karakterizohet nga një kontradiktë themelore. Ajo e maskon synimin e vet për fuqi të fortë me gjuhën e mosndërhyrjes, veçse lëshohet në ndërhyrje taktike që e demaskojnë retorikën e vet. Parimet themelore që pretendon se i mbështet Kina, siç janë sovraniteti, integriteti territorial dhe mosndërhyrja, funksionojnë më shumë si norma izolimi sesa si norma të marrëdhënieve ndërkombëtare. Qëllimi është të ofrohet një lloj mburoje për Kinën nga shqyrtimi i jashtëm, në vend që këto të jenë norma udhëzuese për sjelljen e vet në çështjet ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, Kina udhëhiqet nga marrëdhëniet e fuqisë (së fortë).⁵ Kur i duhet të avancojë interesat e veta gjeopolitike dhe ekonomike jashtë vendit, Kina rregullisht i shkel të njëjtat parime që proklamon se përcaktojnë filozofinë e politikës së vet të jashtme. Për pasojë, në vend të një politike të jashtme koherente, Kina zbaton një qasje të përqendruar tek fuqia që retorikën e mosndërhyrjes e përdor si armë për ta errësuar interferencën e vet.

Historikisht, kallëpi i themeleve ideologjike të politikës së jashtme kineze është nxjerrë nga ato që PKK-ja i përcakton si ideologjitë udhëheqëse (zhidao sixiang) dhe parimet udhëheqëse të politikës së jashtme (wajjiao zhidao fangzhen).⁶ Këto nuk janë qëndrime abstrakte, por korniza autoritative që përcaktojnë identitetin, botëkuptimin dhe strategjinë e Kinës. Truri i politikës së jashtme kineze është vetë autoriteti i centralizuar i Partisë Komuniste Kineze (PKK), e cila e ka ruajtur monopolin mbi vendimarrjen

kombëtare. Politika e jashtme kineze duhet të shihet gjithmonë përmes prizmit të legjitimitetit të brendshëm politik dhe stabilitetit të regjimit. Ky këndvështrim nxjerr në pah një dallim domethënës nga demokracitë liberale, ku marrëdhëniet e jashtme janë të lidhura ngushtë me llogaritjet e brendshme politike. Legjitimiteti i PKK-së, veçanërisht në kohë reformash ose pasigurie, shpesh varet nga aftësia e partisë që të projektojë fuqi jashtë vendit.

Literatura identifikon etapa të dallueshme historike të politikës së jashtme kineze, të karakterizuara nga ndryshime në lidhshmëri dhe në kontekstin global. Sjellja e politikës së jashtme të Kinës mund të kuptohet më së miri përmes evolucionit të perceptimit që Kina ka për veten, i strukturuar si nga rrënjët revolucionare ashtu edhe nga fryma e zhvillimit pragmatik. Velez-Serrano identifikon tri etapa: aktivizmi maoist dhe përafrimi ideologjik, introversioni i epokës së Deng-ut për zhvillim ekonomik, dhe ushtrimi i autoritetit nga Xi Jinping.⁷

Nën Mao Ce Dunin, politika e jashtme u formësua nga një kombinim i internacionalizmit revolucionar dhe mbijetesës pragmatike. Kjo periudhë u shënua nga përballje ideologjike me Perëndimin dhe Bllokun Sovjetik, duke reflektuar thënien e Maos se duhet "anuar në njërën anë" dhe bindjen e tij se "era që fryn nga Lindja po mbizotëron mbi erën që fryn nga Perëndimi", një metaforë për ngritjen e socializmit mbi kalbësirën kapitaliste.⁸ Epoka e Deng Xiaoping-ut shënoi një qasje të rafinuar ideologjike. Mantra e Deng-ut, "fshihe fuqinë, prit kohën e duhur" (taoguang yanghui), pasqyronte një strategji të vetëpërmbytjes, fokusit ekonomik dhe shmangies së qëllimshme të konfrontimit ndërkombëtar. Pesë Parimet e Deng-ut për Bashkëjetesë Paqësore — respekti i ndërsjellë për integritetin dhe sovranitetin territorial, mosulmimi, mosndërhyrja në punët e brendshme, barazia dhe përfitimi i ndërsjellë, si dhe bashkëjetesa paqësore — janë bërë gurthemeli retorik i qëndrimit të Kinës si palë e

5 Shënime nga diskutimi me një studiues të marrëdhënieve ndërkombëtare, 26 qershor 2025 (AC).

6 Velez-Serrano, Mayra, 'U ngrit, u pasurua dhe tani po bëhet e fortë': hyrje në etapat historike të Politikës së Jashtme të Kinës (20 nëntor 2018). *Relaciones Internacionales* 91 (2), 1-23, 2018, në dispozicion në SSRN: <https://ssrn.com/abstract=3373829> ose <https://ssrn.com/abstract=3373829> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.3373829>

7 Po aty.

8 Robinson dhe Shambaugh, eds., 1996.

paangazhuar dhe i filozofisë së përgjithshme në punët e jashtme.⁹ Hu Jintao dhe Jiang Zemin e zgjeruan këtë pragmatizëm, duke e ndërthurur me diskursin e “zhvillimit paqësor”. Megjithatë, siç vëren Marc Lanteigne, zhvillimi paqësor nuk ishte thjesht një qëndrim sa për ta qetësuar Perëndimin, por narrativë strategjike për të maskuar aftësitë në rritje. Ngjitja e Xi Jinping në pushtet në vitin 2012 shënoi ndarjen me atë që mund ta konsiderojmë si introversioni strategjik kinez. Xi ka artikuluar një vizion më të vendosur të përqendruar në ripërtëritjen kombëtare (zhonghua minzu de weida fuxing) dhe Ëndrrën Kineze, një periudhë pragmatizmi revolucionar me ambicie globale, ose një shkrirje e nacionalizmit zhvillimor me vetëbesimin gjeopolitik.¹⁰ Këtë transformim e formalizoi rishikimi i kushtetutës i vitit 2018 në Kinë, i cili hoqi kufizimet e mandatit presidencial dhe sanksionoi “Mendimin e Xi Jinping për socializmin me karakteristika kineze për një epokë të re”, duke e projektuar vizionin e Xi si busull strategjike e qëndrueshme për kombin.

Nën Xi Jinping, politikën e jashtme kineze e udhëheqin tri objektiva kryesore: sigurimi i regjimit, projektimi i fuqisë dhe formësimi i normave globale. Interesat themelore të Kinës — hexin liyi — përfshijnë sovranitetin mbi territoret e kontestuara (Tajvani, Hong Kongu, Deti i Kinës Jugore), sigurinë e regjimit dhe vazhdimësinë e rolit qendror të PKK-së. Megjithatë, Deti i Kinës Jugore mund të mos shihet si territor i kontestuar, por më tepër si territor i pushtuar nga Kina, pasi që Pekini e zgjeroi territorin e vet në ujërat ndërkombëtare. Dhe mënyra si i mbron pushtime të tilla të ujërave ndërkombëtare sipas parimit “Jemi vend i madh, kështu që na duhet më shumë hapësirë për zhvillim” është **qasje thellësisht koloniale**.¹¹

9 Chaubey, M. (1994). I Vendosja e një rendi të ri ndërkombëtar sipas pesë parimeve për bashkëjetesë paqësore: Deng Xiaoping: III Dokumente. Raporti për Kinën, 30(2), 267-279. <https://doi.org/10.1177/000944559403000213> (Punimi origjinal i botuar në vitin 1994)

10 Lanteigne, 2019.

11 Shënime nga diskutimi me një studiues të marrëdhënieve ndërkombëtare, 26 qershor 2025 (AC).

Secili kërcënim i perceptuar ndaj këtyre interesave shkakton përgjigje të mprehta diplomatike ose shtrënguese, si puna e sanksioneve, masave hakmarrëse tregtare ose operacioneve të sulmeve kibernetike. Lanteigne potencon se “mënyra e re e të menduarit në Kinë për rezultatin final (‘dixian siwei’) pasqyron një doktrinë të vijave të kuqe, veçanërisht rreth integritetit territorial, përtej të cilave diplomacia kineze bëhet konfrontuese”.¹² Sa i përket qasjes rajonale, nga fokusi në diplomacinë e periferisë rrethuese (ASEAN, SCO, etj.) Kina ka kaluar në iniciativa globale, si puna e Iniciativës Një Brez, një Rrugë (BRI), e dizajnuar për të thelluar ndërvarësinë infrastrukturore, financiare dhe normative, përfshirë edhe me Ballkanin Perëndimor. BRI është shembull i përsosur i asaj që Robinson e quan “gjeopolitikë zhvillimore”, domethënë shfrytëzimi i **lidhshmërisë ekonomike** për të ndërtuar sfera të influencës pa u dashur të militarizohet haptazi politika e jashtme.

Paketa e mjeteve të politikës së jashtme të Kinës është bërë më e larmishme dhe e sofistikuar. Fuqia e fortë tradicionale mbetet esenciale, veçanërisht në Azi dhe Paqësor. Modernizimi i Ushtrisë Çlirimtare Popullore (UÇP), zhvillimi i kapaciteteve të marinës luftarake oqeanike dhe shtimi i kapaciteteve për luftë kibernetike, janë sinjale të kalimit të fokusit nga mbrojtja territoriale tek prania globale. Kina po përqendrohet gjithnjë e më shumë në projektimin e fuqisë, megjithatë Pekini i njej kufizimet e fuqisë së fortë. Ka investuar shumë në kultivimin e fuqisë së butë përmes Instituteve Konfuci, diplomacisë mediatike (Rrjeti Global Televiziv i Kinës-CGTN) dhe të ashtuquajturës ndihmë për zhvillim, të cilat janë kredi që çojnë në varësi, siç e ka treguar rasti i Malit të Zi dhe vendeve të tjera¹³ Megjithatë, kufizimet e fuqisë së butë në demokracitë liberale kanë çuar në përdorim në rritje të **fuqisë së mprehtë**, ose

12 Lanteigne, 2019, fq. 46

13 Hans von der Brelie. (2021, 7 maj). Autostrada prej 1 miliard dollarësh që nuk të shpie askund, Euronews, <https://www.euronews.com/my-europe/2021/05/07/the-billion-dollar-motorway-leading-montenegro-to-nowhere>

operacione manipuluese ndikimi që shfrytëzojnë shoqërinë e hapur dhe cenueshmëritë demokratike, si në Bashkimin Evropian (BE) ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor. Këtu përfshihet përvetësimi i narrativave mediatike, kultivimi i rrjeteve të elitave dhe shfrytëzimi i varësisë ekonomike, për të cilat Serbia është shembull i përkryer.¹⁴

Angazhimi i Kinës me institucionet shumëpalëshe është i dyvlershëm. Ajo merr pjesë në institucione globale si OKB-ja, OBT-ja dhe OBSH-ja, por shpesh ngrihet kundër normave institucionale që bien ndesh me qasjen e vet që prioritet ka sovranitetin. Pekini ka promovuar edhe institucione paralele (p.sh. Banka Aziatike për Investime në Infrastrukturë (AIIB) dhe Organizata e Bashkëpunimit të Shangait (SCO)) si kundërpeshë ndaj institucioneve perëndimore. Lanteigne argumenton se multilateralizmi i Kinës është funksionalist dhe selektiv, duke preferuar institucione që mund t'i formësojë ose udhëheqë vetë, dhe duke u ngritur kundër atyre që ia kufizojnë autonominë. Për shembull, teksa Kina e kritikon NATO-n për anashkalimin e OKB-së në Kosovë, Libi dhe Irak, ajo njëkohësisht e ka zgjeruar praninë e vet në misionet paqeruajtëse të OKB-së, duke përfshirë edhe dislokime në Mali dhe Sudanin e Jugut.

Përpjekjet e Kinës për ripërcaktim të normave globale janë të dukshme në retorikën e vet rreth “bashkëpunimit fitimprurës për të dyja palët”, “komunitetit me fat të përbashkët” dhe “llojit të ri të marrëdhënieve ndërkombëtare”. Këto koncepte nuk janë neutrale nga pikëpamja ideologjike. Ato e hedhin poshtë premisën

liberalo-demokratike të normave universale, duke e zëvendësuar me prioritetet që lidhen me sovranitetin, mosndërhyrjen dhe stabilitetin e regjimit, duke paraqitur kështu një vizion atraktiv për shumë regjime autokratike ose gjysmë-demokratike, siç është Serbia.¹⁵ Kina e paraqet veten si mbrojtëse të stabilitetit global, megjithatë angazhohet në sjellje që destabilizojnë sigurinë detare dhe merr pjesë në sulme kibernetike ndërkombëtare.

Një dilemë qendrore në interpretimin e politikës së jashtme të Kinës lidhet me **qëndrimin e dyfishtë**: i vendosur por i kujdesshëm, revizionist por i orientuar drejt status quo-së. Kina pretendon se mbështet një rend ndërkombëtar të bazuar në rregulla - por një rend në të cilin rregullat ri-interpretohen përmes “karakteristikave kineze”. Kjo dykuptimësi nuk është e rastësishme. Politika e jashtme kineze e ka oksigjen dykuptimësinë strategjike.¹⁶ Kjo është e dukshme në sjelljen e Kinës në Detin e Kinës Jugore, ku i ka militarizuar ishujt e kontestuar, ndërkohë që promovon narrativën e “ngritjes paqësore”. E dukshme është edhe në qëndrimin e Kinës ndaj çështjeve të kontestuara politike, siç është pavarësia e Kosovës, të cilën refuzon ta njohë. Për t'u dhënë formë perceptimeve publike në nivel global, Kina po përdor gjithnjë e më shumë instrumente të fuqisë së butë, si janë Institutet Konfuci dhe diplomacia digjitale. Megjithatë, këto shpesh shoqërohen me mjete të fuqisë së mprehtë, siç janë propaganda, dezinformimi dhe kapja e elitës në shtete me tendencë autokratike.

14 Teuta Avdimetaj dhe Ramadan Ilazi. (2021). “Përtej konsideratave ekonomike: kufij të rinj të ndikimit kinez në Ballkanin Perëndimor”. Sbunker dhe QKSS, <https://qkss.org/en/publikimet/beyond-economic-considerations-new-frontiers-of-chinese-influence-in-the-western-balkans>

15 Nëmec, J., & Stojarová, V. (2025). Ndikimi ekonomik kinez në Serbi: sinergjia malinje e ndotjes dhe jo-liberalizmit. *Europe-Asia Studies*, 77(4), 638–65. <https://doi.org/10.1080/09668136.2025.2491484>

16 Lanteigne, 2019.

3. Ballkani Perëndimor si rast për interpretimin e politikës së jashtme kineze

Edhe pse mund të mos konsiderohet si prioritet kryesor në agjendën e politikës së jashtme të Kinës, Ballkani Perëndimor është bërë gjithnjë e më atraktiv për Kinën për disa arsye. Pikë së pari, rajoni ofron një pikë të hyrjes në politikën dhe procesin e zgjerimit të BE-së. Serbia, Mali i Zi dhe Bosnjë e Hercegovina janë kthyer në platforma ose kalime esenciale për në tregun evropian për mallrat kineze. Siç është vënë në dukje në hulumtimin e Parlamentit Evropian, “Kina synon një portë hyrëse për në BE nëpërmjet Ballkanit, që paratë e gatshme i kanë të pakta” dhe ka zotuar miliarda dollarë në projekte infrastrukturore dhe energjetike, veçanërisht në Serbi.¹⁷

Së dyti, Kina e promovon e qëndrimin e vet të paangazhuar me perëndimin si aset në politikën e vet të jashtme për Ballkanin Perëndimor.

Ky qëndrim promovon një narrativë të “mosndërrhyrjes” dhe “bashkëpunimit fitimprurës për të dyja palët” që u pëlqen qeverive në rajon, të cilat përballen me presion që t’i realizojnë reformat në procesin e integritimit evropian.¹⁸

Për shembull, zyrtarët serbë shpesh bëjnë dallimin mes kushtëzimeve të BE-së dhe respektit të Kinës për sovranitetin. Dallimi është se kreditë e BE-së dhe mekanizmat e tjerë të mbështetjes financiare për Serbinë kushtojnë më pak dhe janë më transparente, veçse vijnë me kushte.¹⁹ Kjo sugjeron që Serbia e percepton

Kinën si një akter që nuk synon të ndikojë në çështjet e brendshme. Në këtë kuptim, nga një këndvështrim i veçantë, Kina ofron partneritet më “dinjitoz” në sytë e udhëheqësve, të cilët e kanë më të vështirë të punojnë me akterë si BE-ja, e cila në këmbim të mbështetjes kërkon që të respektohen normat demokratike dhe të drejtat e njeriut. Megjithatë, perceptimi se në një farë mënyre mbështetja e Kinës është e mirë dhe pa kushte, është thjesht perceptim, pasi që në realitet mbështetja kineze nuk është pa kushte (domethënë, çka do të ndodhte nëse Serbia, bazuar në politikën e vet të jashtme të supozuar të mos-angazhimit/shumë-vektoriale, do të zgjidhte një politikë më neutrale ndaj Tajvanit?). Për ta kuptuar më mirë rolin e Kinës në Ballkanin Perëndimor, ku Kina duket benevolente, ndërkohë që i përforcon butësisht varësitë, mund të na ndihmojë koncepti i **dyvlershmerisë strategjike**, i eksploruar në veprën e Homi K. Bhabha.

Së treti, qëndrimi i Kinës ndaj Kosovës ka funksion të brendshëm dhe gjeopolitik njëkohësisht. Duke mos pranuar ta njohë Kosovën, Pekini synon të duket i përkushtuar ndaj asaj që në këndvështrimin kinez do të shihej si parimi i “mosndërrhyrjes”, si dhe të fitojë pikë me Serbinë.

Megjithatë, roli i Kinës në Ballkanin Perëndimor nuk është i pakontestuar. Bashkimi Evropian e sheh përfshirjen e Kinës si një fragmentim potencial të procesit të zgjerimit dhe të përafrimit të rajonit me normat dhe standardet e BE-së. Megjithatë, edhe politika e BE-së për rolin e Kinës në rajon është e dyvlershme, dhe Kina gëzon marrëdhënie të mira me disa shtete anëtare të BE-së. Në këtë kontekst, Ballkani Perëndimor është kthyer në terren prove për

17 Matthieu Burnay, Dr. Kolja Raube, dhe Prof. Dr. Jan Wouters, Politika e Jashtme dhe Marrëdhëniet me Jashtë të Kinës (Studim i kërkuar nga Komiteti për Punë të Jashtme i Parlamentit Evropian), 2015

18 Analizë e tekstit nga deklaratat e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kinës

19 Branimir Jovanović dhe Sonja Stojadinović. “Grantet dhe kreditë e BE-së dhe Kinës në Ballkanin Perëndimor”, prill, 2025, Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw),

shtytjen e Kinës drejt botës, një model ndikimi që shmang konfrontimin, por gradualisht thëllon praninë e vet ekonomike, politike dhe të sigurisë, duke lëvizur gjithnjë e më shumë drejt krijimit të një shkalle varësie. Kohët e fundit, Serbia ka blerë pajisje ushtarake kineze, duke përfshirë sisteme të mbrojtjes ajrore dhe dronë luftarakë.²⁰ Sipas Krstinovska et al. (në vitin 2023, Serbia mban gati dy të tretat e të gjitha kredive dhe kontratave kineze në rajon).²¹ Veç Serbisë, edhe Mali i Zi nënshkroi me Bankën për Eksport-Import të Kinës një kredi kontroverze prej 1 miliard eurosh për ndërtim autostrade. Në Maqedoninë e Veriut, kompanitë kineze u përfshinë në projekte ndërtimi të autostradave, të cilët më vonë u njollosën nga akuza për korrupsion. Shqipëria mbetet më e kujdesshme, duke e kufizuar përfshirjen kineze në sektorë jo-strategjikë. Shkaku i përafritimit të plotë me partnerët e vet, SHBA dhe BE, Kosova ka mbajtur angazhim minimal me Kinën. Infrastruktura digjitale është kthyer në vektor të rëndësishëm të ndikimit kinez.²², me Huawei-n që ka siguruar qasje në infrastrukturën kritike.²³

Në angazhimin e Pekinit në Ballkanin Perëndimor duket se ndikojnë tri motivime kyçe. Së pari, Ballkani Perëndimor është **me rëndësi gjeostrategjike**, dhe Kina e sheh rajonin si një pjesë integrale të Iniciativës së vet “Një Brez, një Rrugë”. Së dyti, Ballkani Perëndimor mund t’i ofrojë Kinës **një levë për ndikim në raport me BE-në**. Teksa Kina mbështet zyrtarisht integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor

në Bashkimin Evropian, lidhjet e veta dypalëshe, veçanërisht me Serbinë, i minojnë interesat kolektive të BE-së, siç është përhapja e normave nga institucionet demokratike në fusha të tjera të politikave. Së treti, Kina po përfiton nga ajo që e percepton si ndjenjë të **lodhjes me zgjerimin në BE**. Me pak përparim që nga Samiti i Selanikut i vitit 2003, shumë shtete të Ballkanit mbeten në hava nga pikëpamja gjeopolitike.²⁴ Objektivat e Kinës në Ballkanin Perëndimor ndahen në tri kategori të gjera. E para, rritja e mbështetjes për Kinën në çështjet ndërkombëtare. Kina e vlerëson mbështetjen diplomatike për politikën e vet “Një Kinë” dhe parimin e mosndërhyrjes në punët e veta të brendshme. Serbia ka qenë veçanërisht e zëshme, me Presidentin Vuçiq që i ka përshkruar marrëdhëniet si “miqësi e çeliktë” dhe Xi Jinping që iu përgjigj duke iu referuar Serbisë si “partneri më i ngushtë i Kinës në Evropë”. E dyta është zgjerimi i tregut dhe qasja në kontratat publike. Firmat kineze përfitojnë nga praktikat e paqarta të prokurimit në Serbi, Republikën Srpska dhe në Bosnjë e Hercegovinë, duke i anashkuar shpesh normat mjedisore dhe të punës si kombëtare ashtu edhe ato të BE-së, përmes ndërprerjeve normative dhe balancimit të butë. E treta, Kina nuk promovon një alternativë ideologjike ndaj BE-së, por përkundrazi përqendrohet në “përfitim të ndërsjellë” dhe “mosndërhyrjen”, duke u ofruar elitave lokale, veçanërisht atyre me tendencë autoritare, një narrativë të përshtatshme për të shmangur reformat.

Prania në rritje e Kinës në Ballkanin Perëndimor krijon si fërkime ashtu edhe kompleksitet për ambicet e BE-së dhe NATO-s në rajon. Bazuar në analizën e hulumtimeve ekzistuese, tri efekte janë më të spikatura në ndikimin në rritje dhe të pakontrolluar kinez në rajonin tonë: i pari është dobësimi i ndikimit të BE-së dhe erozioni i fuqisë transformuese të procesit të integritimit evropian. I dyti është minimi i kohezionit gjeostrategjik në Ballkanin Perëndimor, duke qenë se **Pekini mëton ta fragmentojë arkitekturën e sigurisë në rajonin tonë**. I treti dhe më shqetësuesi është efekti normativ, pasi që “zhvillimi autoritar”

20 Reuters, Serbia potencon rëndësinë e pajisjeve ushtarake kineze, 23 tetor 2023, <https://www.reuters.com/world/serbia-highlights-importance-chinese-defence-equipment-2023-10-23/>

21 Ndikimi i Kinës në procesin e anëtarësimit në BE të Ballkanit Perëndimor: sinergji dhe pengesa.

22 Sasha Dragojlo, “Huawei i Kinës hap Qendër Teknologjike, duke konsoliduar praninë në Serbi”, 15 shtator 2020, Balkan Insight, <https://balkaninsight.com/2020/09/15/chinas-huawei-opens-tech-centre-consolidating-presence-in-serbia/>

23 Në vitin 2020, Huawei nënshkroi një marrëveshje me Zyrën e Serbisë për Teknologjitë e Informacionit dhe Qeverisjen Elektronike, për të vendosur pajisje nga Huawei në Qendrën Shtetërore të të Dhënave në Kragujevac. <https://e.huawei.com/en/news/ebg/2020/serbia-office-egovernment-agreement>

24 Krstinovska, et.al., 2023

i Kinës paraqet një model alternativ potencial ku bashkëjetojnë rritja, kontrolli shtetëror dhe praktikat autoritare. Sipas Krstinovska et al., projektet e financuara nga kinezët zbatohen duke shpërfillur standardet e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit.²⁵

Roli i Kinës në Ballkanin Perëndimor është

²⁵ Po aty, fq. 12

malinj, haptazi **armiqësor dhe oportunist**. Kina po ngulitet në rajon duke vepruar nëpërmjet bilateralizmit dhe partneritetit me elitat që preferojnë qeverisjen autokratike, si Presidenti Vuçiq. Deri kur BE-ja dhe NATO-ja të krijojnë një përkufizim të qartë të qëndrimit të tyre ndaj Kinës në rajonin tonë dhe të hartojnë një përgjigje të fuqishme, ndikimi dhe prania kineze në Ballkanin Perëndimor ka gjasa të vazhdojnë të rriten.

4. Analiza e diskursit të politikës së jashtme kineze ndaj Kosovës

Ky punim përdor një kornizë të analizës së përmbajtjes dhe narrativës për të ekzaminuar si e ndërton Republika Popullore e Kinës narrativën e vet politike rreth çështjes së Kosovës. Qasja metodologjike përdori një sistem kodimi të strukturuar, tematik dhe të bazuar në ndjenjë për të analizuar fjalimet, deklaratat, intervistat dhe burime të tjera nga zyrtarët publikë kinezë. Në mënyrë të ngjashme, ne përdorim një metodë të analizës binare të përmbajtjes, të plotësuar nga interpretimi narrativ cilësor, duke u fokusuar në praninë ose mungesën e kategorive tematike të paracaktuara në 82 tekstet burimore parësore.

Korpusi i analizës përfshiu 82 tekste të disponueshme publikisht, të botuara midis viteve 2008 dhe 2024 nga zyrtarë dhe institucione shtetërore kineze. Këto grupohen në tri kategori:

- > **Tekstet 1–23:** Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) Konferenca për Shtyp dhe Deklarata.
- > **Tekstet 24–79:** Fjalime të mbajtura në Këshillin e Sigurimit të OKB-së (KS i OKB-së) lidhur me Kosovën.
- > **Tekstet 80–82:** Fjalime dhe intervista nga udhëheqës të lartë kinezë në lidhje me Ballkanin Perëndimor.

Secilit teksti iu caktua një identifikues unik dhe u analizua individualisht për të ruajtur kuptimin kontekstual të secilës fjalë. Dokumentet u shqyrtuan në versionet e tyre origjinale në gjuhën angleze, të ofruara nga burime zyrtare të qeverisë kineze ose nga të dhënat e verifikuara të OKB-së.

Të frymëzuar nga analiza e kodit operacional dhe të përshtatur për këtë rast, ne zhvilluam një skemë kodimi binar (1 = prani, 0 = mungesë) për të regjistruar nëse një tekst i caktuar

përfshinte në mënyrë të qartë një ose më shumë nga temat e mëposhtme, të cilat janë sovraniteti dhe integriteti territorial, dialogu, veprimet e njëanshme, OKB-ja, BE/NATO/SHBA. Secila temë u përcaktua qartë në dizajnin tonë të brendshëm të hulumtimit, duke siguruar kritere të përfshirjes dhe përjashtimit, si dhe citate ilustruese, për të siguruar besueshmërinë ndërmjet koduesve. Kodimi u validua në mënyrë të kryqëzuar nga një kodues i dytë për 20% të teksteve, duke na dhënë përputhje prej mbi 90%.

Nga të 82 dokumentet e analizuar: 66 tekste përfshinin deklaratat që përfshinin mbështetje për sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë; 65 përmendnin mbështetjen për dialogun si metodë e preferuar për zgjidhjen e konfliktit; 22 kritikonin veprimet e njëanshme të Kosovës; 63 i referoheshin autoritetit të OKB-së, veçanërisht Rezolutës 1244 të KS të OKB-së; 15 përfshinin portretizime antagonistike të SHBA-së ose NATO-s. Vlen të përmendet se BE-ja nuk ishte paraqitur në mënyrë të qartë si antagonist në asnjë nga tekstet, një gjetje që nxiti reflektim kritik rreth kategorisë origjinale të kodimit.

Analiza e 82 burimeve që i referohen Kosovës nga Kina nga viti 2008 deri në vitin 2025 ka zbuluar se Pekini ka mbajtur qëndrim kryesisht konsistent, duke u përafuar me qëndrimin e Serbisë ndaj Kosovës. Megjithatë, ka pasur disa rregullime të vogla në qëndrimin e Kinës. Kina ishte deri diku më neutrale në vitet e para (2008–2011). Që do të thotë se, teksta mbështeste Serbinë, gjithashtu inkurajonte përparimin në dialog dhe i përgëzonte të dyja palët për avancimin në pajtim. Megjithatë, teksta sistemi ndërkombëtar u bë më i polarizuar, Kina ka mbajtur gjithnjë e më shumë qëndrim më mbështetës ndaj Serbisë. Për krahasim, në vitin 2008, një deklaratë nga Pekini pohonte se "Kina e vlerëson frymën e arsyeshme dhe

përmbajtjen e demonstruar nga Serbia dhe Kosova”, ndërsa në vitin 2023 Pekini shprehej se “autoritetet e Kosovës ndërmorën përsëri veprime të njëanshme, këmbëngulën në mbajtjen e zgjedhjeve në veri të Kosovës dhe shpallën rezultatet e zgjedhjeve pavarësisht pjesëmarrjes prej më pak se 4 për qind, duke çuar në përshkallëzim të konflikteve lokale dhe tensioneve rajonale. Kina është thellësisht e shqetësuar për këtë” (Teksti 77; 29).

4.1 Gjetjet kryesore

Diskursi i Kinës rreth Kosovës karakterizohet nga një narrativë e kalibruar me kujdes që riafirmon parimet e veta themelore të politikës së jashtme, përputhet fort me Serbinë, si dhe ruan njëfarë fleksibiliteti. Përmes analizës sonë të 82 teksteve, duke përfshirë konferenca për shtyp, fjalime në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe deklarata të nivelit të lartë, Kina mëton sistematikisht ta portretizojë veten brenda një kornize normative të përqendruar në sovranitet, legalitet dhe multilateralizëm. Analiza zbulon një hierarki të qëndrueshme të temave: mbështetje për integritetin territorial të Serbisë (132 përmendje), mbështetje e dialogut (130), thirrje në autoritetin e OKB-së (126), kundërshtim ndaj veprimeve të njëanshme të Kosovës (44) dhe kritikë ndaj Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s (30). Bashkimi Evropian, megjithëse përmendet herë pas here, nuk paraqitet qartazi në mënyrë antagoniste, por kjo nënkuptohet.

Afirmimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të Serbisë

Pozicioni i Kinës i shprehur me më shumë konsistencë, ka të bëjë me mbështetjen e vet të qartë për Serbinë dhe, nga këndvështrim i Pekinit, për sovranitetin dhe integritetin

territorial të Serbisë. Ky formulim, i artikuluar 132 herë në 82 tekstet e analizuara, pasqyron një vazhdimësi më të gjerë në politikën e jashtme kineze, veçanërisht ndjeshmërinë e kineze ndaj atyre që shihen si lëvizje secesioniste. Teksa zyrtarët kinezë shpesh e përshkruajnë rastin e Kosovës si “unik” (Teksti 79), mbrojtja e pretendimeve territoriale të Serbisë duhet të kuptohet gjithashtu si interes vetanak për Kinën, pasi ajo i frikësohet zhvillimeve në lidhje me Tajvanin, Xinjiang-un dhe Tibetin. Në mënyrë domethënëse, ky pozicion është intensifikuar në momentet e paqëndrueshmërisë ose përshkallëzimit të perceptuar në terren. Deklaratat kineze përsërisin shpesh se “sovraniteti duhet të respektohet” dhe se “çështja e Kosovës” nuk mund të zgjidhet jashtë kornizës për të drejtën ndërkombëtare. Ky theks retorik shërben për një funksion të dyfishtë: mbrojtjen e Kinës nga precedentët e mundshëm në të ardhmen që mund të zbatohen për sfidat e veta të brendshme, si dhe për projektimin e një imazhi të konsistencës parimore në skenën globale.

Legaliteti përmes Kornizës së OKB-së: Rezoluta 1244 dhe roli i UNMIK-ut

E lidhur ngushtë me optikën e sovranitetit është edhe thirrja e përsëritur e Kinës për Organizatën e Kombeve të Bashkuara si forumi i duhur për adresimin e “çështjes së Kosovës”. Në 126 raste, Kina riafirmon se Rezoluta 1244 e KS të OKB-së mbetet gurthemeli i rendit juridik ndërkombëtar që rregullon statusin e Kosovës. Zyrtarët kinezë vazhdimisht theksojnë se UNMIK-u mban një mandat neutral dhe se asnjë zhvillim institucional jashtë kornizës së OKB-së nuk mund ta ndryshojë këtë status (Teksti 73). Këmbëngulja e Kinës për epërsinë e Rezolutës 1244 duhet parë si përpjekje për ta ancoruar çështjen brenda një forumi ku Kina ka të drejtën e vetos. Duke vepruar kështu, Pekini u reziston proceseve, përfshirë dialogun e udhëhequr nga BE-ja, që mund të konsolidojnë

shtetësinë e Kosovës jashtë mundësive të kufizimeve shumëpalëshe. Veçanërisht, kur misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK) i zvogëloi operacionet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Kina i përshkroi këto ndryshime si “teknike” dhe jo pasqyruese të një ndryshimi thelbësor në qëndrimin e OKB-së. Strategjia këtu është delikate, por esenciale, pasi që duke e paraqitur praninë e vet ndërkombëtare përmes një rezolute neutrale dhe ligjërisht të detyrueshme, Kina kërkon të delegjtimojë pretendimin e Kosovës për shtetësi pa u angazhuar në konfrontim të hapur.

Mbështetje e kufizuar e Dialogut

Mbështetja për dialogun shfaqet në 130 tekste dhe përfaqëson temën e dytë narrative më të shpeshtë. Pekini duket se e mbështet dialogun midis Kosovës dhe Serbisë si mjetin kryesor për zgjidhjen e kontestit, duke e cituar shpesh Dialogun e Brukselit (Tekstet 12, 13). Megjithatë, mbështetja e Kinës për dialogun shoqërohet nga një mungesë interesi po aq e dukshme për të marrë pjesë drejtpërdrejt. Teksa jepet mbështetje retorike, Pekini e pozicionon veten jashtë procesit. Kjo zgjedhje e narrativës bëhet që Kina të jetë në gjendje ta hedhë poshtë secilin rezultat të procesit, pasi që në thelb, për Pekinin, sukcesi i dialogut të normalizimit mund të jetë i dëmshëm për interesat e veta. Qëndrimi më i gjerë i Kinës është të duket konstruktive pa marrë përsipër risk politik ose pa u përfshirë në procese të udhëhequra nga BE-ja, të cilat nuk mundet t'i formësojë ose në të cilat nuk mundet të ndikojë. Kjo gjithashtu pasqyron një qasje instrumentale ndaj dialogut të normalizimit, të cilin Kina e sheh si mekanizëm që i ruan pretendimet e Serbisë për statusin. Kina gjithashtu e përdor në mënyrë selektive kornizën e dialogut, veçanërisht kur përmend nevojën që Kosova të zbatojë marrëveshjet e dakorduara më parë, siç është krijimi i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe (Tekstet 26, 27).

“Veprimet e njëanshme” të Kosovës si burim destabilizimi

Narrativa e “veprimeve të njëanshme” të Kosovës është temë e përsëritur, e pranishme në 44 nga tekstet e analizuara. Kina vazhdimisht i portretizon si destabilizuese dhe të paligjshme lëvizjet e Kosovës për vendosjen e sovranitetit, qoftë përmes veprimeve në veri për vendosjen e rregullimit koherent të monedhës apo përmes konsolidimeve institucionale (Teksti 79). Ky konceptim vepron brenda një strategjie më të gjerë diskursive nga Pekini që i ndihmon portretizimit të Serbisë si akteri “ligjor” dhe “i orientuar drejt dialogut”, për dallim nga veprimet e supozuara provokuese të Kosovës. Duke i etiketuar këto lëvizje si “të njëanshme”, Kina mëton ta portretizojë Serbinë si të lidhur me multilateralizmin dhe sundimin e ligjit, teksa Kosovën e portretizon si të lidhur me trazira dhe paligjshmëri.

Diferencimi i Perëndimit

Në 30 prej teksteve, Kina mban qëndrim më kritik ndaj Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s. Kjo paraqitje antagoniste mbështetet shumë në kujtesën rreth ndërhyrjes së NATO-s në vitin 1999 dhe, veçanërisht, në bombardimin e ambasadës kineze në Beograd (Teksti 82). Këto ankesa rifuten periodikisht në diskursin bashkëkohor si përkujtesa të “unilateralizmit dhe intervencionizmit perëndimor”. Kina i konsideron Shtetet e Bashkuara përgjegjëse kryesore për luftën e Kosovës dhe i paraqet si akter destabilizues në rajon (Teksti 21). Megjithatë, kjo kritikë nuk vlen njësoj për të gjitha entitetet perëndimore. Bashkimi Evropian trajtohet me më shumë nuanca dhe njihet si lehtësues i dialogut të normalizimit, me kusht që të mbajë një pozicion neutral (Tekstet 74, 76, 79). Misioni i BE-së, EULEX, përshkruhet gjithashtu me terma të favorshëm.

Pajtimi dhe pakicat

Përtej narrativave gjeopolitike, Kina thirret periodikisht edhe në temat e pajtimit, bashkëjetesës dhe të drejtave të pakicave (Tekstet 25, 26, 72). Edhe pse këto referenca janë më pak të shpeshta, ato shërbejnë si funksion simbolik. Duke u fokusuar në nevojën për t'i mbrojtur komunitetet pakicë dhe për të promovuar pajtimin, Kina dëshiron të pozicionohet si akter normativ i përkushtuar ndaj paqes dhe kohezionit shoqëror. Është ironike ama, që historiku kinez me të drejtat e njeriut është katastrofik jo vetëm në nivel vendi, por edhe globalisht.²⁶

Delegjitimimi i autoritetit moral të Kosovës

Mes viteve 2008 dhe 2013, Kina iu referua vazhdimisht akuzave për trafik të paligjshëm të organeve në Kosovë (Teksti 64), duke përfshirë një citim formal të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (S/2011/43) (Teksti 67). Këto deklarata shërbejnë si akuza morale, duke e pozicionuar Kosovën jo vetëm si të paligjshme politikisht, por edhe të kompromentuar nga pikëpamja etike. Fatkeqësisht, pretendimeve

të tilla nga Kina dhe Rusia, veçanërisht akuzave për trafik të organeve, shpesh u është bërë jehonë nga zyrtarë të BE-së, pa asnjë provë për t'i mbështetur ato. Akuza të tilla, në kontekstin e politikës së jashtme të Kinës, luajnë rol delegjitimues në narrativën më të gjerë të Pekinit: Kina vë në pikëpyetje gatishmërinë e Kosovës për shtetësi, ndërkohë që minon pretendimet për njohje. Por ka edhe kontradikta në qëndrimet kineze. Teksa Kina avokon në mënyrë aktive kundër shtetësisë së Kosovës, ajo gjithashtu ka ofruar një sinjal të vogël se mund të jetë e hapur për ndryshime.

Kosova si rast unik.

Një vëzhgim i rëndësishëm në qëndrimin e Kinës ndaj Kosovës është dykuptimësia e saj në lidhje me implikimet më të gjera të rastit të Kosovës. Teksa e refuzon me vendosmëri deklaratën e pavarësisë së Kosovës, Kina e ka përshkruar gjithashtu rastin si "unik" (Teksti 79), duke sugjeruar një hapje të mundshme ndaj pranimit. Kjo gjuhë i mundëson Kinës ta mbajë qëndrimin e vet aktual, duke ruajtur njëkohësisht mundësinë për të ndryshuar qëndrim nëse ndryshojnë rrethanat.

26 Amnesty International. "Kinë: Vazhdimi i udhëheqjes nga Xi Jinping është katastrofë për të drejtat e njeriut." 23 tetor 2022 <https://www.amnesty.org/en/latest/news/2022/10/china-xi-jinpings-continued-tenure-as-leader-a-disaster-for-human-rights/>; Kenneth Roth, "Kërcënimi Global i Kinës për të Drejtat e Njeriut", Human Rights Watch (HRW), <https://www.hrw.org/world-report/2020/country-chapters/global>

5. Analiza e qëndrimit të politikës së jashtme të Pekinit ndaj Ballkanit Perëndimor

Ky seksion e zhvendos thjerrëzën analitike nga analiza e diskursit e përcaktuar metodologjikisht tek vlerësimi më interpretues dhe kritik i pozicionimit të politikës së jashtme të Kinës ndaj Ballkanit Perëndimor, me fokus të veçantë në dialogun e normalizimit Kosovë-Serbi. Teksa Seksioni 4 përdori një qasje të strukturuar të kodimit narrativ dhe të analizës së dokumenteve, seksioni 5 i sintetizon këto njohuri empirike për të vlerësuar dimensionet e qëndrimeve të politikës së jashtme kineze, duke përfshirë preferencat e veta, aleatët e perceptuar, kornizat normative dhe heshtjet strategjike. Me “analizë të qëndrimeve”, ky seksion i referohet leximit interpretues të qëndrimeve të politikës së jashtme të Kinës duke shkuar përtej deklaratave eksplicite për të vlerësuar prioritetet e nënkuptuara, modelet retorike dhe llogaritjet gjeopolitike. Ballkani Perëndimor, edhe pse periferik në diplomacinë globale të Kinës për sa i përket shkallës, përfaqëson një hapësirë diskursive funksionale nga pikëpamja ideologjike dhe strategjike për Pekinin.

Analiza zhvillohet në tre pjesë. Nënseksioni i parë ekzaminon në përgjithësi Ballkanin Perëndimor në diskursin e politikës së jashtme të Kinës, nënseksioni i dytë eksploron qëndrimin e Kinës ndaj Kosovës, duke gjurmuar diskursin legalist që përputhet në mënyrë të qartë me Serbinë, ndërsa nënseksioni i tretë merret me qasjen e Kinës ndaj dialogut të normalizimit Kosovë-Serbi të lehtësuar nga BE-ja, duke identifikuar një qëndrim retorik që duket sikur e mbështet dialogun, por në praktikë nuk dëshiron që ai të ketë sukses. E gjithë analiza nënvizon se angazhimi i Kinës me Ballkanin Perëndimor nuk është **as pasiv dhe as neutral ideologjikisht**. Qëllimi nuk është të dominohet rajoni, por të krijohen varësi dhe të formësohet orientimi i tij

politik në mënyra që mbështesin narrativat dhe interesat më të gjera të politikës së jashtme të Kinës.

5.1 Ballkani Perëndimor në diskursin e politikës së jashtme të Kinës

